

INTERVISTË ME HANËMSHAHE ILAZIN

Prishtinë | Data: 14 mars, 2024

Kohëzgjatja: 74 minuta

Të pranishëm:

- Hanëmshahe Ilazi (E intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Hanëmshahe nëse mundeni me u prezantu, me na tregu diçka për prejardhjen, familjen e juv të parë?

Hanëmshahe Ilazi: Sigurisht. Quhem Hanëmshahe Sopaj Ilazi, e lindur në fshatin Saraishtë, afër Ferizajt. Megjithëse, jo bash në fshat, vetëm shtëpia jonë ka qenë si me thonë në periferi të Ferizajt. Po unë kam dëshirë me thonë prej Saraishtës se aty osh mbajt Kuvendi i Ferizajt, me 1908. Rrjedh nga një familje bujqish, po bujq pëerparimtarë, atdhedashës edhe arsimdashës. Se qysh në kohën e Jugosllavisë vjetër xhaxhai im ka qenë medresant i Shkupit, bile ka qenë me ni dhomë me akademikun Idriz Ajeti. Atje kishin qenë shumica e nxanësve që kanë studiu aty komunist. Edhe axhën e kom pasë komunist.

Gjyshi edhe babai ata kanë qenë atdhetar (buzëqeshë), kundër komunizmit kanë qenë. A gjyshi im qysh në kohën e Jugosllavisë vjetër hallën time e ka çu në shkollë pesë vjeçe në gjuhën serbo-kroate edhe atëherë kanë jetu në fshatin Gadime. Osht shumë interesant rrojët e familjes, po s'po hi anej. Krejt fshati janë leçit prej gjyshit tim, "Pse po e çon vajzën në shkollë, do të bohët shkinë¹". Edhe unë jam prej vajzave të para nashta nga fshatrat që jam shkollu në Ferizaj. Shkollën fillore e kom kry në Ferizaj edhe Normalen e kam krye në Ferizaj me pesë vite. Vitin që kaloj e patëm bile 62 vjetorin e maturantave të parë të Ferizajt. Edhe kemi festu 150 vjetori i formimit të qytetit të Ferizajt edhe 62 vjetori i normalistëve të parë. Na ka organizu kryetari i komunës.

E familjarët janë atdhetarë, edhe du me tregu se qysh si fëmijë une kam qenë kur gjyshi im tri herë është burgosë, për fjalë të lirë. Se përpara që jane majtë tubimet. Bile një herë kam qenë ndoshta në klasën e tretë fillore, Bajram, ishte festë, ka qenë Mehmet Hoxha në mledhje, edhe ky si... se agjën ma kanë vra ma vonë, q'atë komunistin. Ka qenë në rend të parë [gjyshi] e ky me tre shokë tjerë janë marrë vesh para mledhjes, "Ti do flasësh kështu, ai kështu, une kështu". Edhe ky e çon gishtin, "A ka dikush me fol?" del gjyshi im, në sallë të kinemasë kanë qenë. Edhe i thotë, "O Mehmet Hoxha ti e ke vendin këtu, jo në Beograd" edhe thotë... ai gjithmonë fliste me alegori gjyshi, edhe ne na mësonte ashtu.

¹ Fjalë denigruese për serbët.

“Une kam” thotë “dele. Edhe kur don me i qethë delet duhet me i la përpara mandej i qethim. Po ato delet nuk hyjnë në ujë, e marrim ni dele e hudhim në ujë, {bën sikur kap dhe lëshon diçka} mandej ato të gjitha shkojnë mas tyne. Edhe ju e keni çu dikon atje në Turqi edhe na tash si dele mas atyne”. Sipas këtyne fjalëve gjyshi që më ka tregu ai thjesht ka ardhë me agjitu për shpërngulje për Turqi. Edhe po sa ka dalë prej sallës kinemasë e kanë marrë edhe e kanë burgos. Edhe ata shokët e vet, njëni ndryshe ka fol, tjetri ndryshe, te tretë i kanë burgosë. Po ky si baba i dëshmorit e kanë liru pas tre mujsh. Disa herë kështu ka fol edhe e kanë burgos.

Në shkollën fillore sa kam qenë, ato librat që i kena pasë të historisë thjesht kemi mendu se na jemi pasardhës të sllavëve, jo pellazgëve e ilirëve. Edhe ni rast, hala kur nuk kam lexu e nuk kam ditur, megjithëse bisedat me prindë edhe gjithmonë na futshin në kokë se sërëbët i kemi armiqë, armiqë shekullorë. Po unë disi si fëmijë nuk besojsha, thua se e urrejsha babanë tim, “Pse po flet ashtu”. Se i kisha do shoqe që udhëtoja, malazeze kanë qenë, edhe menojsja që janë të mira (buzëqeshë). Deri sa në Normale e kam lexu librin “*Plitvičke borbe*” “Luftërat e Sanxhakut të Nishit”, kur i kanë përzon 1876-’78, diku rreth 700 fshatra i kanë rrafshu edhe 200 e sa mijë shqiptarë i kanë përzon prej trojeve të veta.

E një ushtarak serb, oficer kishte shkru për ngjarjet krejt çka kanë ndodhë edhe krimet që i kanë bo ata, edhe i kanë lonë dorëshkrim, q’atë dorëshkrim vajza e vet e kishte botu edhe ne na ra në dorë, mrena natës e kom lexu a beson, se duhej të dorëzohej shokut tjetër me vazhdu. Edhe atëherë e kom kuptu se çka janë serbët. Megjithëse në shkollë ishim bashkë, në lojëra e krejt edhe në punë. Pasi e kreu Normalen u punësova si mësues në shkollën fillore “Gjon Serreçi”. Gjon Serreçi qitu osht i pushkatuar {tregon nga ana e djathtë} në Strelishtë² i kanë thonë.

Anita Susuri: Taukbashqe.

Hanëmshe Ilazi: Në Taukbashqe. Bashkë me shumë atdhetarë të tjerë, me Ajet Gërgurin e të tjerë. Në atë shkollë kam punu dy vite. Mandej ndërkohë e kreu Shkollën e Lartë Pedagogjike. Dy vite jo po dy gjenerata, prej klasës parë deri katërtën, përpara katër klasës kanë qenë klasët e ulëta të fillorës. Mandej dy vite kam punuar në çerdhe të fëmijëve në Ferizaj, drejtoreshë e çerdes kam qenë. E mbas atyre dy viteve jemi shpërngul në Prishtinë edhe jam punësua atëherë e kreu edhe fakultetin, grupin e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Jam punësuar në shkollën “Elena Gjika” ish “Vuk Karagjiqi”. Kam dhonë aty 20 vite kam punuar si profesoreshë e gjuhës shqipe.

Anita Susuri: Po du pak m’u kthy, mos të gutemi (qeshë). ‘46-tën jeni e lindur edhe në kohën kur keni qenë fëmijë ka qenë pak pas Luftës së Dytë Botërore, periudhë shumë e shpejtë. Qysh ka qenë krejt jeta, qysh e kujtoni ju jetën e familjes juj, rrethit, lagjes ku keni jetu?

² Nga gjuha serbe *strelishte* - vend për pushkatim.

Hanëmshahe Ilazi: Aty s’kemi pasë fqinjë fare. Po familja jeme kanë qenë kështu bujq po të pasur. Kemi pasë tokë mjaft, kopshte, ara, livadhe, lopë, dele, bullica. Kemi qenë të pasur mjaft. Mirëpo shteti na ka...

Anita Susuri: Konfisku?

Hanëmshahe Ilazi: Jo që na ka konfisku po ka marrë tatime shumë. E une s’e maj në men’ kur ja u kanë marrë edhe miellin prej magjës, token ja u kanë marrë, grunin, misrin. Unë katër vjeçe kam qenë kur më ka vdekë nëna. Edhe kjo osht ni... unë e kam shkru ni libër “Rrënjët e familjes” gjyshti im është kryepersonazh. Edhe une dyshoj që një aktiviste serbe ajo ma ka myt nonën. Nona mu ka vra. Unë e mbaj mend ashtu veç gjakun {prekë barkun}, ni jastëk, se neve na largojshin prej dhomës. Babai im shkoi me kalë shpejt e shpejt në qytet e mori ni mjek. Ai veç e mbshtolli me fashë e maj në mend ajo fasha e bardhë u skuqke prej gjakut. Na qitshin jashtë. Nona më ka vdekë prej gjakderdhjes edhe pa mjek, se s’ka pasë mjekë. Si ka pasë plagët në organet vitale edhe të ja kishin hekë gjysën e zorrëve, ajo ndoshta kishte jetu. E dyshoj se është vra, i kanë qit bombë në oxhak, te shpia e zjermit, ku kanë gatu.

Anita Susuri: Bukë tu bo.

Hanëmshahe Ilazi: Po. Kena pasë vëllaun e gjyshës, njerks babës tim, po ate e kena pasë si gjyshe, s’e na ka rritë. Shtatë fëmijë kemi qenë, gjashtë motra e ni vëlla. Motra ma e vogla ka mbetë gjashtë mujshe, e motra ma e madhe 16 vjeçe. Na ka rritë kështu me rradhë. Edhe kur paskan ardhë me na marrë grunin e misrin, qekjo sërbyja, paska hy në kosh, grunin e kanë marr po tash edhe koshin edhe misrin. E mamaja ime e paska marrë sëpatën edhe te dera e koshit me sëpatëka thonë, “Une gjallë e ti me dalë gjallë prej këtuhit kurrë jo, se boll ma morrët millin e grunin e tash edhe misrin do em m’i lonë fëmijët pa bukë”.

Ajo [serbja] frigohet shumë edhe i thotë babasë tim “Largoje grunë prej këtuhit se po ta jap fjalën që asni kokërr misër s’ko me marr”. Edhe baba ja bon disi me shejë nonës, se baba mandej mu më ka tregu edhe i thotë “Largohu ajt shko te shpia se po qajnë fëmijët a po digjet buka”. Ajo po sa largohet, kjo del edhe ikën. Mirëpo ajo e ka ditë krejt terrenin e shtëpisë sonë. Edhe besoj që... se ‘50-tën nona mu ka vra. Ajo [serbja] e ka gjujt atë bombën, se aty ka qenë nona edhe q’ajo njerka. Ajo pak është plagosë, nona shumë edhe prej asaj ka vdekë.

E ne jemi rritë qashtu, mandej baba ni kohë nuk u martu, ka qenë i ri, po prapë u martu dhe bëri prapë fëmijë (buzëqeshë). Qishtu osht ajo fëmijëria ime edhe rinia. Megjithëse mirë kemi kalu se ata nuk na kanë pengu në shkollim, nuk na kanë pengu në martesë për kenë mu martu. Ate që e kemi dashtë e kemi marr, kështu që po thom kanë qenë familje përparimtare. Por shumë i kanë mundu edhe pse kanë qenë, e kanë pasë djalin komunist e udhëheqës ka qenë e krejt, po megjithatë prapë edhe i kanë burgosë edhe babën edhe gjyshin. Gjyshin ma shumë se ai ka fol shumë.

Edhe ma vonë kom qenë e rritur, Titoja kur vinte në Kosovë, në Ferizaj kur vinte, e kom këtu {tregon me gisht majtas} fqinj Sinan Sahiti, ai ka qenë kryetar i Komitetit në Ferizaj. E gjithmonë gjyshin tem e merrshin e shtishin në hotel edhe e mbyllshin se mos po del em fol diçka (qeshë). Edhe ni rast thojke [Sinan Sahiti], “Më vinte gjyna që e mbylla” edhe kur ka shku e ka nxjerrë i ka thonë, “Ç’a ke dashtë me i thonë Titos?”, “Jo bre, unë s’kom dashtë me fol keq, mirë i kisha thonë, ‘Ti je shumë i mirë po ata për okolla i ki të këqi’” (qeshë).

Anita Susuri: Aha (qeshë). E zonja Hanëmshahe më tregut që...

Hanëmshahe Ilazi: Edhe diçka desha me ju thonë.

Anita Susuri: Po?

Hanëmshahe Ilazi: Shtëpinë tonë ku e kemi pasë aty thashë në Saraishtë, dy herë i kemi pasë kolonistat që na kan uzurpu shtëpinë. Unë ate nuk e mbaj në mend po gjyshi që më ka tregu, edhe në atë monografinë që e kom bo për gjyshin edhe familjen, jam konsultu edhe me historianë. Se krejt Ferizaji e dinë që gjyshi jem i ka dal edhe *kralit* [srb.: mbretit] ish Jugosllavisë përpara. Megjithëse, historiani Liman Rushiti doktor shkence osht më thoshte jo *kralit* po Nikolla Pashiqit³ i ka dal në Shkup. Gjyshi është marr vesh me ushtarak të kazermës, ka qenë afër, i ka korruptu thjesht ata edhe ata i kanë tregu ku ka me ardhë *krali*. *Krali* në Ferizaj ka qenë 1923-tshën.

Edhe ky ka prit, kur ka zbrit ai prej trenit, gjyshi im aty, ata xhanarët e rrethojnë me pushkë e me ato çka i kanë pas që kanë dashtë me vra. *Krali* ja çon dorën, “Mos e ngucni”. Ai i bjen në gjunjë, thotë, “Lartmadhëri unë jam durëthatë s’kom dal me ju vra, po e kom ni lutje ndaj jush”. Ai i thotë, “Urdhno” a dinë, “çka ki me thonë?”. Thotë, “Mu nana më ka vdekë, po s’më ka lone amanet që më ka lone vllazën në Crnagore [Mal të Zi]. E ata kanë ardhë tash më kanë hi në shpi, e une po flej në hamar”. Edhe ai thotë, “S’osht e vërtetë se na nuk i kemi çu nëpër shpija po nëpër meraja”. Meraja ato kanë qenë vende të thata, kishe aty.

Ky thotë, “Jo, hajdeni kqyrni”. I thotë, “Ktheje shpinën” edhe ja shkrun ni dokument {bën sikur shkruan diçka në dorë}. Thotë, “Qet dokument çoje nesër në komunë” edhe ai e dërgon. Ata vijnë meniherë i hekin ata kolonistat prej shtëpisë. Po thoshtë gjyshi, “Nuk shkun meniherë, në bashçe i hapën shatorat” a dinë m’u kthy prapë. Po mandej vijnë i marrin edhe i çojnë me një fshat Muzeqinë. Edhe ma vonë, i kom në libër edhe mbiemrat e atyne kolonistav kush kanë qenë, po këta të fundit i mbaj në mend ata deri ‘43-shin aty kishin qenë. Kur kanë ardhë italianët e shqiptarët që thojmë kishe Shqipëria e Madhe, që nuk osht term i joni Shqipëria e Madhe e kanë bo sërëbët. Edhe ata Sllepçeviq janë thirrë,

³ Nikolla Pashiq (Serbisht: Nikola Pašić; 18 dhjetor 1845 - 10 dhjetor 1926) ishte një politikan dhe diplomat serb dhe jugosllav. Gjatë karrierës së tij politike, e cila zgjati gati 4 dekada, ai shërbeu 5 herë si Kryeministër i Serbisë dhe 3 herë si Kryeministër i Jugosllavisë. Ai luajti një rol të rëndësishëm në themelimin e Jugosllavisë dhe konsiderohet si një nga figurat më me ndikim në historinë serbe të shekullit të 20-të.

po ata vet dalin, s'e tash mendojnë që do t'i vrasin dalin, edhe nuk ka pasë problem me ta. E po mendoj që ka qenë familje e përndjekur, thjesht e përndjekur.

Anita Susuri: E më tregut pak për shkollimin, shkollën fillore e keni përfundu në Ferizaj?

Hanëmshahe Ilazi: Edhe shkollën e mesme, kom qenë nxanëse e shkëlqyshme (buzëqeshë). Edhe në fakultet kom qenë e mirë.

Anita Susuri: A ka qenë fshtirë për juve me vazhdu shkollimin si vajzë për shembull në atë kohë?

Hanëmshahe Ilazi: Jo nuk ka qenë fshtirë se prindët s'më kanë pengu. Ama fakultetin e kom kry masi jom martu. Fshtirë ka qenë se edhe punoja edhe me fëmijë të vegjël. Po vullneti bon gjithçka edhe kom qenë ndër studentet më të mira.

Anita Susuri: E po më intereson koha e rinisë, sa keni qenë në Normale, shkollë fillore, a ka pasë aktivitete kulturore që keni marr pjesë?

Hanëmshahe Ilazi: Po, ka pas, ka pas. Une jom bile me ni libër më kanë shti, kom marr pjesë në teatër. Disa shfaqje i kemi mbajt, ni shfaqje nihere ni profesor i joni i artit Shfaqet Shllaku ai na ka përgadit ketë të Haki Stërmillit "Sikur të isha djalë". Unë e kom pas rolin e Dijes edhe e kom lujt mirë se kom qenë me njerë. Mandej mbasi e kom kry Normalen, hala pa e kry vitin e katërt-pestë, në "Peripetitë e kohës" kom marr pjesë Kristë Berisha e ka shkru atë komedi ka qenë, e rezhiser ka qenë Qazim Dushku.

Po mendoj ka pas aktivitete. Mandej shkrujsha une si e re poezi, orë letrare mbajshim. Bile kemi qenë një vjet në Aleksinc, në Serbi kemi qenë, me majt orë letrare shkolla jonë. Ajo shkolla Normale e Aleksincit kish qenë vetëm vajza. E mandej mu m'u kujtua se një kolege e imja më pat thonë që ata me qëllim i kanë pregadit mësuesit në Serbi edhe i kanë dërgu në Kosovë me punu edhe me detyrë me u martu me shqiptarë. S'e shumica që janë martu me shiptarë, ai shiptari u kthy u bo serbofil së fëmijtë i kanë fol sërbsisht, kemi iks raste të tilla.

Edhe motra medicinale kishin pas çu. Ata gjithmonë kanë punu me direktiva, me plane për shkombëtarizim të shqiptarëve. Edhe shkombëtarizim edhe shfarosje. Ai Vasa Çubrilloviq⁴ i ka bo dy elaborate, një me 1937 në kohën e *kralit*, e një e ka bo në kohën e Titos 1944-shin. Edhe Titoja u dakordu me atë program. Une bash në qet monografinë që jam ka e punoj, po boj krahasime Titoja edhe *krali*, gati nisoj. Krali ka bo marrveshje me Turqi për shpërngulje të shqiptarëve 1938-tën, Titoja e ka bo

⁴ Vaso Çubrilloviq, (serbisht: Vaso Čubrilović; 14 janar 1897 - 11 qershor 1990). Ishte historian, politikan dhe akademik jugosllav, i dekoruar me dekoratën e federatës Jugosllave për praktikimin e Doktrinës së shenjt serbe. Çubrilloviq ishte një nga studiuesit jugosllav që kanë kryer studime për zhdukjen e shqiptarëve. Studimi i tij njihet me emërtimin "Iseljavanje Arnauta".

1953-tën, e ka përtri atë marrveshje. Prapë nuk ja ka arrit qëllimit megjithëse shumë janë shpërngul në qato vite sidomos aksioni i armëve kur ka qenë.

Aksioni i armëve kur ka qenë '56-tën, une kam qenë klasën e tretë apo të katërt fillmore s'jam e sigurtë. Halla ime me burrë e me fëmi u shpërngul për Turqi, disa kusheri tanë u shpërngulën. Në Ferizaj aty stacioni i trenit ka qenë si Petro Marko thotë "Lëndina e lotëve". Edhe stacioni i trenit te na ka qenë si lëndina e lotëve, ata që ikshin për Turqi edhe këta që i përcillnin, qanin kur u ndajshin, s'di, s'di ka qenë e tmerrshme, e tmerrshme ka qenë. Edhe ato të gjitha i kom përjetu.

E gjyshi im jo, edhe ju thoshte, "Deri sa une nuk shpërngulem, mos u shpërngulni". Se ka qenë edhe pleqnar gjyshi im. Vinin e pytshin, "Çka të bojmë, a të shkojmë?". "Deri sa une rri këtu ju mos gaboni me shku, në qoftë se unë nisna atëherë edhe ju". E nuk jemi shpërngul, a mbas 20 viteve hallën time e ka kthi në Kosovë. Me niqin probleme, se ata po sa i çonin edhe mbiemrat ju ndrojjshin. Por e ka kthi.

[Këtu ndërprehet intervista]

Hanëmshahe Ilazi: Kur kam punu në "Elena Gjike", "Vuk Karagjic" përpara, '87-tën tetor, 16 tetor 1987, ato e mbaj mend mirë shumë, isha kujdestare e ditës edhe s'pata shumë orë atë ditë. Dy orë po si kujdestar u dufke me nejt hala edhe drejtori ka qenë shqiptar. Thotë, "Hanëmshah, eja në zyre se u bo ni rast". Thash, "Çfarë rasti?". "Ni nxanës i klasës gjashtë i joni e paska shty derën e vc ni vajzës klasës tetë". Thash, "Hajt more mos më boni problem, çfarë... Pune e madhe e ka kap zorri djalit. Edhe neve profesorav na e shtynë derën". Edhe kurgjo erdha në shpi, Po zavendës drejtoresha ka qenë shumë e ngarkume, ni shovene mos vet.

Edhe ajo e ka thirrë nonën e qasaj vajzës edhe i ka thonë, "Shko lajmroje në Sekretariat të Punëve të Brendshme, se ka dashtë me dhunu atë vajzën". Ky fëmija i klasës gjashtë me dhunu vajzën e klasës tetë. Unë isha kryetare e pleqsisë shkollës edhe atë botë kryetari i pleqësisë, kryetari i sindikatës, kryetari i partisë, drejtori, pesë kanë qenë edhe kryetari i partisë, a e thashë? Ata bojshin nifar Komiteti për Mbrojtje e Vetëmbrojtje, qashtu u thirrke. Edhe masdite po më thirrë drejtori në telefon, tha, "Hanëmshah duhesh me ardhë në ora pesë e kemi mledhjen". Thash, "Çka u bo?". Tha, "U bo kijameti". Thash, "Valla në pra pesë kom mledhje të prindërve", këtu te shkolla Normale, ish Normalja e Prishtinës. E kisha djalit e vogël. Thash, "Ko me shku niherë në mledhje mandej vi, veç sigurisht vonona".

Edhe shkova une në mledhje të prindërve, bisedova me kujdestaren, "A ka ndonji problem?" tha, "Jo". Thash, "A bon une me shku se e kom prapë në shkollën njëfarë problemi?". Edhe shkova, fati që u vonova. Se gjithmonë unë i majsha proceset në mledhje, se e kom ditë mirë gjuhën serbo-kroate edhe serbisht edhe shqip me u kry mledhja ma shpejtë. E ajo e kish fillu procesin qekjo zavendës drejtoresha. Edhe une s'nejta rahat, si hina mrena në derë, thashë, "Zoti ju marroftë" serbisht, "Sram

vas bilo, [srb.: Turp të keni] po e shfrytëzoni situatën politike veç qashtu”. Se atëherë ishte ajo situata murgeshat patën dal publikisht “Po na dhunojnë shiptartë” e s’di çka, s’di a ju kujtohet juve?

Anita Susuri: Jo.

Hanëmshahe Ilazi: Ju jeni të reja. Edhe u ula, ajo e kish fillu proçesin. Thash, “Fëmi bre në klasën e gjashtë”, fillimi ka qenë, fillimi i vitit shkollor, tetori. Sa ka pas mi pas 11 vjeç, 12 vjeç. Ajo tha, “Jo edhe fëmija tetë vjeç munët me dhunu”. Edhe ajo vet gaboj, se qajo nxanësja kishte ardhë prej ni shkollës tjetër, “Milladin Popoviq” ka qenë tash “Pjetër Bogdani” a s’di qysh thirrët. Ka Kolovica atje në film të rrugës. Kishe edhe atje paskan dasht me dhunu po ni shiptar e paska pshtu. Edhe kurgjo, po tash megjithatë s’kishim drejt me përjashtu fëminë, megjithatë ja ndërrun shkollën, prej shkollës tonë e çunë në “Emin Durak”. Edhe u kry mledhja ajo e majti proçesin, sjellje e pahijshme e fëmijës, *nepristojno ponašanje deteta*, serbisht e shkrujt.

Edhe u kry, erdha në shpi, të nesërmen shkova në shkollë, ish mush shkolla me persona të sigurimit edhe më thirrën mu në zyre, me më marr në pyetje, “Pse ki fol, qysh ki fol?” se unë thash, “Edhe ajo paska qenë problematike edhe vajza”, masi tha ajo ashtu. Thash, “Une çka kom bo, kurgjo s’kom bo se e kom mbrojt ni fëmi që ja ka shty derën, edhe neve na e shtyjnë derën, po s’osht kurgjo ajo”. Megjithatë, përdit mledhje, mledhje, mledhje. Edhe ish 200 vjetori i Vukut, Vuk Karagjiqit, gjithë ditën në shkollë, e bonëm revistën e shkollës, jo grupet recituse jo fletushka, çka po di une. Emri jem kërkun nuk figurojke se une armike.

Edhe erdh koha me më përjashtu. P’i partisë ma së pari, se më patën zgjedhë qysh si nxanëse anëtare të partisë se isha e familjes përndjekur edhe ajo më konvenojke që me punu. Edhe erdhën une e bona me shkrim arsyetimin, e lexova shqip nihere, mandej sërabisht. Thash, “Ku kam fol?”. Se atëherë ishte problem vishin gra, bile me 16 tetor ‘87-tës njo 200 serbe sigurisht kanë ardh para shkollës e tu më kërcnu, qato s’ja fali drejtorit, se që ka votu kundër ndasht se e ka rujt vendin e punës, po më detyroj me dal para atyne me u arsyetu. Une hiq su arsyetova, thash, “Kurgjo s’ka qenë”.

Po më kërcnojshin, “Kena me të vra” e s’di çka. Prej shkollës teme kanë ardh tani te shpia e Fadil Hoxhës, që e patën degradu edhe heroin, qato gratë bojshin probleme. Edhe aty në mledhje thash, “Ku kom fol, a kom fol në rrugë, kom fol aty që muj me thonë mendimin tem lirisht”. Thash, “Na në atë mledhje e kemi cilësu si sjellje e pahijshme e fëmijës, e tash” e thash me ironi, “tash masi Sekretarijati i Punëve të Brendshme e paska cilësu si tentim dhunimi edhe unë po pajtona” po demek s’ka qenë atëherë ashtu. Thash, “Lë të lexohet proçesi i asaj date” fati që se kom shkru une po e ka shkru ajo vet.

Edhe kur u lexu proçesi u pa, ato ja nisën me qajt a beson, si artiste {imiton të qarat}. “Qysh po munesh me thonë Hanëmshah je edhe ti nonë”. Thash, “Po, jam nonë po s’ka pas kurgjo aty”. Edhe u ula. Mirëpo para se me fillu mledhja ka qenë ni mësuse serbe e Ferizajit e martune për ni gjerman në Obiliq, ai gjermani ja boni ni fëmi ja la banesën edhe iku shkoj në Gjermani. Ajo ka qenë nifarë

pijanece, kur kalojke në korridor i vinte era alkohol mos vet. Edhe para mledhjes une e mora ato po flas. Thash, “A po të dukna une nacionaliste? Ti bile më njeh mu prej Ferizajit, kush jam e tek”. Edhe ka ora dhet e gjys e natës, ajo p’e çon gishtin {ngritë dy gishta}, I thanë, “Urdhno?”. Tha, “E kom autobusin e fundit në ora 11:00”. Atëherë s’ka pas shumë taksi si qetash në çdo kohë. E tha, “Nuk muj me shku ndryshe”.

“Ani” thanë “po të lëshojmë po çka ki me thonë për Hanëmshahin?”. Ajo ja nisi me më lavdu mu, “Hanëmshahi” tha, “ka qenë nxanësja ma e mirë në Ferizaj, ka qenë te Titoja” më patën çu si nxanëse e mirë për 25 maj atëherë më kanë çu te Titoja. Edhe tha, “*Prevelika kazna je isključenje*, denim i rondë është përjashtim”, demek parapërjashtim. Edhe kur tha ajo jo përjashtim unë e dita që pshtova, se i pata llogarit sa vota, llogarita që edhe drejtori ka me votu kundër. Edhe 14 me 15 vota e qasaj serbës më pshtoj parapërjashtim. Parapërjashtim amo në korridor a beson, kom thonë edhe në televizion bile publikisht, disa prej shoqeve të mia, “Qekjo shkoj” demek, “mos të na përlin edhe neve”, as nuk mu lajmërojshin.

A disa me përjashtim më prujshin edhe me veturë në shpi. Se ato më kërcnojnë, unë si njëfsha mjafton me më gjujt me ni guri a diçka. “Kena me të vra” qesi sene palidhje. Edhe nejse hala punojsha në shkollë edhe prapë nuk nejta rahat une. ‘89-shin kur hinën minatorët në zgafellë, telegram mbështetës në emër të krejt arsimtarëve të shkollës “Vuk Karagjiq” të shqiptarëve. E disa që po thom, rrahin gjyks që janë patriote, thojnë, “S’na ke pyt Hanëmshah krejtve”. Thash, “Pse a kishe qenë kundër me të pas pyt a?” thash, “s’ka pas kohë me pyt secillën, veç me çu telegram sa ma shpejtë”. “Jo s’kisha asi, po me na pas pyt”. Edhe u kry kjo.

E mas qasaj, mas këtij telegramit erdhën në shkollë tre, dy shiptarë kanë qenë, ni serb. Njenit s’ja harroj emrin kurrë Selim Guxhufi o thirrë. Edhe para se me fillu mledhja unë çova gisht, thash, “A bon une ni pytje”, thash, “Qat denimin parapërjashtim që është dasht sipas statusit në qoftë se s’ki bo ndonji delikt tjetër mas gjashtë mujsh me ta hekë atë dënim” thash, “ju s’ma keni hekë, kanë kalu dy vjet” u bo ‘89, ke ‘87, dy vjet. E qai Guxhufi ju tha, qishtu {imiton qëndrimin e personit} po thom diqysh (qeshë)... Tha, “Bre ti kurrë mos me pasë qenë e denume ki me u përjashtu, na e kemi përjashtu vajzën e vëllaut Zenel Hajdinit, heroit popullit” e demek kush je ti.

Edhe une thash... e gjujta librezën e partisë ‘89-tën e kom gjujt une, para tjerëve. Thash, “Çoni gishtat shokë” edhe vet e çova gishtin se këta paskan vendos me më përjashtu mos të zgjat mledhja. Edhe nja dy prej shokëve të mi kolegë që i kom pas, Jusuf Pirraku edhe Demë Cukaj, ai Dema ka vdekë, tha, “Valla me na i pre dy gishtat se nuk e çojmë gishtin për Hanumshahin”. Neise më përjashtun, punova edhe ni vjet a dy, zgjata vallahi, po hala ishin do mjekë tonë në spital edhe u shiva, than, “Duhet me u shtri në spital”. Përnime kisha problem me tension të gjakut, kom pas problem edhe hala kom me trombe. I bona do dokumente edhe mas ni kohe ‘96-tën dola në pension.

Pjesa e Dytë

Hanëmshahe Ilazi: Masi dola në pension u kyça, shkrujsha qishtu ka pak në gazeta, artikuj të ndryshëm. Edhe kur filloj lufta u kyça në luftë, në logjistikë. E kom furnizu spitalin ushtarak të Likovcit me barna, me aparaturë, me gjithçka. Gati çdo ditë kom qenë në Drenicë, s'ka fshat Drenicës që s'kom qenë. Edhe ata më thojshin, "Ti je bija jonë" (qeshë). Edhe po thom najher, "Jom prej Drenicës", ata, "A po mendon përnime?", "Jo" po thom, "po më ka pranë Drenica si vajzën e vet" (qeshë).

Anita Susuri: Adoptim (qeshë).

Hanëmshahe Ilazi: E kom pasë ni shoqe, me Teutën kom punu, me Flora Brovinën, Nebih Balaj, mo ai çdo ditë, jo veç çdo ditë, po ka ndodhë dy herë në ditë, tri herë në ditë, ata kanë shku [në Drenicë] me Kadri Dushin, Kadrijën e kanë vra, ai ka qenë shofer. Jo veç në zonë Drenicës, po në të gjitha zonat ata kanë punu, une ma shumë në Drenicës. Ajo shpesh me veturë të vet, Fatime Berisha. Ato e kom pasë, s'po di, si motër si nonë se ma e vjetër pak se unë. Shumë e mirë. Shofere, ajo vozitke. I qitke syzat {përshkruan dukjen}, ni sheshir, e ka ditë gjuhën mirë, serbo-kroate se ka jetu në Sarajevë. Edhe shpesh mendojshin që o sërbe.

A ni rast a beson krejt dy karrikat e mramne të veturës edhe krejt gepekun e kena pasë plot me barna e me rroba i kamuflojshim. Aty veç ni batanije ja qitëm përmi edhe na nalën qaty përtej Obiliqit se shkojshim rrugicave, aty nër hekurudhë, hishim ka Dobroshevci, ka Guri Plakës. Kur mrijshim te Guri Plakës mo anej nuk guxojshin, nuk na njëkshin, a deri aty po. Edhe e shtini kryt ai polici edhe se çoj Zoti me çu atë batanije me pa. Ajo Fatimja e ndjera shumë më dhimët se ka hjekë shumë amo shumë e mirë ka qenë. Thojke, "Hanëmshah mos u frigo se kom knu tespindhovën". E më ka metë mu qajo tespindhova gjithë thom na ka shpëtu (qeshë).

Edhe i çojshim masanej në Likovc barnat, e atje ma shumë kom bashkëpunu me doktorin Fadil Beka, ai është fenomen edhe Lec Gradica. E Fadili ma së pari në Ticë, në shpi të vet e ka hap spitalin, mandej në Likovc. Me neve ka qenë edhe doktor Mujë Shala, gruja e tij Xhevahire Shala, Izyfeti, [Ajnishahe Azemi](#), Xhemile Ruhani plotë shoqe kemi qenë që kemi vazhdu. Veç une kom shku me Fatimën gati vazhdimisht.

Edhe bash në Likovc kemi qëllu kur osht plagos Muja, Mujë Kapuçi, Mujë Krasniqi, herën e parë kur u plagos. Edhe lypshin gjak, na e lajmërum ekipën e mjekëve edhe erdhni, ma përpara ka pasë ardhë, doktori Ali Zatriqi, edhe e kam shënu se e kam edhe ditarin e luftës "Drenicë jemi me ty", në atë libër kam shkru. Ai vet ka hi, se ka thonë, "Jam zero, grupin zero" prej krahut vet direkt i ka dhonë gjak Mujës. Mandej kanë ardhë ekipa e mjekëve e kanë opera, ai mas dy java prapë ka dalë në front. Herën e dytë mandej u vra, më duket në Llapushnik u vra.

Anita Susuri: Po du edhe pak mu kthy ma herët, në kohën kur keni fillu aktivizmin si shumë e re, me leximin e librave...

Hanëmshahe Ilazi: Po, kom lexu shumë. Edhe hala lexoj. Une s'muj e kam ushqim shpirtëror, s'muj pa lexu. Ju tregoj bibliotekën që e kom.

Anita Susuri: Për librat e ndalum për shembull që kanë qenë në atë kohë, në kohën kur keni qenë nxanëse, studente, qysh ka fillu krejt kjo? Për shembull për grupet ilegale kur keni kuptu?

Hanëmshahe Ilazi: Une s'kom qenë në grupe ilegale, po i kemi adhuru, se une si fëmi e kom lexu librin e Adem Demaçit "Gjarprinjtë e Gjakut". Dhondrin, burrin e motrës e kom pasë mësus, burrin e hallës mësus, djali hallës mu ka vra '82-shën, '81-shën mu ka vra nipi i hallës në demonstrata të Ferizajit, me 3 prill. Mbas një vjeti '82-shën ky bash djali hallës ka organizu për nder të atina edhe e kanë marr edhe e kanë torturu shumë.

Në Ferizaj osht shtëpi e seksionit të punëve të brendshme, pesë katëshe, ai prej katit pestë gjoja se ka kcy. Nuk e besojmë hiç po ata e kanë torturu shumë ju ka vdekë në durë e mandej e kanë hedge prej dritareve, gjoja se ka kcy. 19 vjeç ai, a ky i pari nipi i hallës 26 vjeç, e ka lonë ni djalë edhe nusën shtatzanë, ajo mandej lindi bineç dy djem. Po njëni binak mas ni viti i ka vdekë, amo dy i ka edhe ajo kurrë mo su martu, a shumë e re ka mbetë e vejë.

Anita Susuri: A janë të njejtës hallë?

Hanëmshahe Ilazi: Jo, dy hallave, dy hallave.

Anita Susuri: E a ju kujtohet juve krejt kjo, '81-ta?

Hanëmshahe Ilazi: Po, po qysh jo. Qysh s'më kujtohet. Bile para se me fillu '81-shi në Prishtinë, ka pasë përpara nëpër shkolla edhe armë për vetëmbrojtje a mbrojtje, qashtu. Edhe e kena pasë nifarë komiteti edhe na shtijshin me kujdestaru natën, a ishte orë policore. Edhe ni kolegia ime, une atë nate s'kom qenë, ka vdekë e ndjera, ka qenë arsimitare e artit, tu dashtë me hi në shkollë gati me vra policia, se s'ka mrrë me hi para orës policore. Rrihim në shkollë kot, me rujt shkollën, a plot rrugët policë ishin.

Po thom kanë qenë kohë të mrapshta, kohë të fshtira kanë qenë po megjithatë kena vazhdu. Na largun prej shkollës ni kohë s'patëm mësim hiç. Mandej na lejun katin përdhesë na shiptarë që ishim shumë ma shumë, ata shumë pak ka pasë sërbe në shkollë tonë. Ma shumë ka pas romë në paralele sërbe. Bile më kujtohet një rast, një mësuse e mire ka qenë Shipiq e ka pasë mbiemrin. Ka qenë mësuse e mirë, e lavdërojshin. Edhe në mledhje të fundvitit ose në gjysëm vjetor që bojshim mledhje për me

tregu suksesin tha, “*Verovali ili ne*, besoni ose jo i kom vetëm katër sërbë në klasë, krejt tjerët romë. Për qato s’kom mujt me pasë sukses”.

Une, s’kom mujt kurrë me hesht (buzëqeshë), i thash, “Ti falenderoj qatynë romëve se me katër nxanës s’kishe mujt me pasë klasë. Po i ke pasë ata edhe e ke formu klasën”. E po thom gjithmonë mi kanë majt në mend ato çka kom fol edhe për qato masanej deshtën me më largu prej shkollës edhe krejt.

Anita Susuri: Domethonë ‘81-tën ju keni qenë...

Hanëmsaha Ilazi: Po në Prishtinë kam qenë, po, po.

Anita Susuri: A ju kujtohet qyteti?

Hanëmsaha Ilazi: Qyteti, a beson Isame Ajvazi e Prizrenit, edhe ajo ka qenë kolege e gjuhës, dolëm prej shkollës i lëshum nxanësat me shku në shpi, e nëpër qytet nëpër qendër, atëherë kom banu te ngrohtorja atje e kom pasë banesën. Ni kohë ajo thotë, “Gjak!” në rrugë, une e majsha për dore se s’ka qenë mirë edhe. “Jo” thash “çfarë gjaku, hecë, hecë Isame”. Dojke mi ra të fikët edhe ni koleg i jemi qai Jusufi me to e kapëm për dore.

Kur mrrinëm ka rruga, semaforat kryesorë aty, aeroplanat rrafsh me ndërtesa beso kalun, tenkat, e çova ato deri në shpi, une vazhdova në komë në shpi. Kur shkova fëmijë, fëmijë e mi edhe të kojshive, shokët e shoqet e fëmijëve ishin ardhë te une. Si pulat {dridhet dhe tkurr supet} ishin bashku. Kanë qenë në “Hasan Prishtinë” ata në shkollë. Drejtori ka qenë sërb, në qat’ kijamet i kish lëshu nxanësat, aty tanksat gjithka edhe aeroplana sipëri. Po s’kanë dashtë ata me i mbrojt fëmijë.

A kur kom punu une në fillim, po thom ka dallime edhe në qat rast osht shumë me randësi me ju tregu, drejtori ka qenë sërb kur jom pranë une në shkollë Okileviq, nuk e di qysh e ka pasë emrin Okileviq. Ama ka qenë shumë principiell. Ka qenë edhe ai sigurisht kolonist i rrethit Ferizajit. E Qazim Dushku ja keni ni zonin sigurisht, profesori, ai ka qenë boem, ka qenë artist, ka qenë kangëtar, ka pikturu. Ka qenë shumë, shumë i aftë, po ka pi shumë. Edhe gjithmonë e kemi pas pas orës së dytë pushimin e gjatë 15 minuta.

Edhe ishte ora e dytë, hala pa u kry ora, nja 15 minuta pa u kry ora, po më troket dikush në derë. Kur po hin drejtori, une thash, “Urdhnoni, shoku drejtor” serbisht “*Izvolte*”. Tha, “Hanëmsaha une po rri te fëmijë, te nxanësit, ti dil se Qaza, profesori Qazimi osht në derë të shkollës me shishe në dorë. Ish dejë. Në mujsh me tërhekë që mos me pa nxanësit”. Me ja rujt autoritetin e arsimitarit. Ajo më ka lonë mu përshypje shumë edhe gjithmonë e tregoj këtë rast. Edhe une dola se ai më donte, se edhe më ka pasë nxanëse mandej edhe kolegë u bonëm.

Edhe pi thom, “Hajde Qazë po shkojmë, po kom qef me ardhë te ti”, afër shkollës e ka pas shtëpinë, “po pijmë kafe”. “Jo, s’du” s’mujsha me hekë, çka me bo. Hypa edhe niherë nalt, e takova arsimtarin e matematikës, ka qenë ni Shefqet Kamberi, prespan ka qenë, ka vdekë edhe ai i ndjeri. Thash, “Shefqet eja pash Zotin, bashkë mujshim me hekë Qazën”. Edhe ka dal qashtu. “Jo, ani po shkojmë qaty” afër shkollës ka qenë nifarë pije, alkohol pijshim ma shumë, çaja, burra krejt. Atëherë s’ka pasë, kërkush s’ka hi në kafe femrat.

Edhe une me ni anë, ai me ni anë e kapëm zhag qashtu {bën sikur bart diçka}, afër shkollës e shtinë ato. Ata kqyrshin {bën sikur e habitur} krejt që hina une (qeshë). E qita ni çaj veç sa me ulë ato. E lamë ikëm në shkollë, kur erdha në shtëpi, p’i thom burrit, “Gruja jote me pijaneca” a dinë (qeshë). Edhe i tregova, tha, “Shumë mirë paske bo që e keni hekë prej derës shkollës mos me pa nxanësit”. A drejtori sërb ka qenë. Po du me thonë nuk janë krejt njerëzit nisoj, po në përgjithësi ata janë... s’po di qysh me thonë. Prej fëminisë i mësojnë edhe fëmitë me na urrejt, edhe krejt, thu se na jemi armiqë tyne.

Anita Susuri: Po më intereson edhe pas qetyne ngjarjeve ‘81-tës a është mbajt edhe mbledhje në shkollë, a është kërkë edhe qëndrimi i secilit?

Hanëmshahe Ilazi: Jo, jo na s’kemi guxu... Po mledhje na shtishin mi majt që mi kritiku na demostrusit. Po jo na s’kemi qenë me i dënu. Edhe prindët na përkrahën shumë, bojshim protesta kur na largun prej shkollës, më kujtohet ni rast Namani e ka pasë mbiemrin ai prindi, a vajza tina Vjollca, ka qenë nxanëse e mirë. Ai i verbët ka qenë në dy sytë prindi. Edhe hypi mbi ni bankë aty para shkollës, “Këta po dojnë me na lonë neve qorra” ai vet ishte i verbër, “Me na mbyll shkollat”. Edhe fëmitë edhe nxanësit protestojshin edhe na. Edhe ka qenë ky bokseri Nazif Gashi e kom pasë vajzën e tij Fitore, nxanëse e shkëlqyshme ka qenë. Edhe ai po thotë, “Profesoreshë që ka nevojë une edhe me grusht” {mbledhë grushtin}. Thash, “Jo, jo na me paqë po kërkujmë të drejta tona”.

[Këtu ndërprehet intervista]

Hanëmshahe Ilazi: Kemi punu nonë mujë pa asni cent. Edhe a beson Anitë, ka pasë burroë e gru që kanë qenë në arsim ata s’kanë pasë të ardhuna kurrfare. E mu për shembull më punonte burri edhe shumicës, e na mledhshim të holla, ata që nuk kishin kurrfarë të ardhunash ja bojshim nifarë rroge. E tash po më bren edhe po më duket shumë e dhimbshme që po bojnë greva, qe vitin e kaluar, ata kur na mbyllshin shkollat na çka bojshim e këta vet po i mbyllin shkollat për të ardhuna. Pse s’po bojnë greva për kualitet të mësimi?! Nuk e di, kanë ndryshu kohët, kanë ndryshu qëndrimet, kanë ndryshu raportet.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt edhe, më thatë ‘96-tën jeni pensionu.

Hanëmshahe Ilazi: Po.

Anita Susuri: '97-tën, Lidhja e Gruas Shqiptare.

Hanëmshahe Ilazi: Po, jam antarësu. Flora ka qenë kryetare e Lidhjes së Gruas Shqiptare për Kosovë, për Maqedoni ka qenë Shpresa Sinani edhe Eqreme Rusi po më doket. Se bashkëpunojshim na edhe me ata. E '98-tën kemi shku edhe në Tiranë, une me disa shoqe. Ka qenë Federata e Gruas Shqiptare i kam edhe fotografitë. Bile edhe ky Ilaz Romajli ka qenë si përfaqësues i Kosovës në Tiranë. Me dy vetura kemi shku, une, qekjo, e pata marr Fatimen, qat' shoferen teme Fatime Berishën me veti. Saime Zeqiraj ka qenë, [Gjylshene Berisha](#) edhe ka qenë Naxhije Doçi.

E Ilaz Romajli na boni ni kontakt me shku te ambasadorja e Amerikës, ak qenë Mariza e ka pasë emrin, mbiemrin s'di, e kam fotografinë në atë librin "Drenicë jemi me ty". Edhe na pranoj, edhe kemi fol sërëbisht me te, e kishte pasë nonën kroate edhe dinte mirë serbo-kroatisht. Edhe me të vërtetë po thom ndonjëherë nashta qashtu janë tu na majt amerikanët hala mos me mujt me u antarësu në asnjë organizatë ndërkombëtare.

Ajo na tha, "Ju do të pavarsoheni", po njëfarë autonomije qashtu me na majt. Kajher po ju thom fëmive, "Moti më ka thonë qishtu ajo ambasadorja" (qeshë). Tani na boni takim me Et'hem Ruka ka qenë minister i arsimit edhe me ate jemi pasë taku. Ka vepru Lidhja e Gruas Shqiptare, patëm majt në Institutin Albanologjik ni ekspozitë. Përpara na i patëm kërku, se me fëmi punojsha une në Qendrën për Mbrojtjen e Gruas edhe Fëmijës edhe vizatime nëpër shkoll aju patëm dhonë temë "Lufta në sytë e fëmijëve". Edhe ka pasë shumë piktura të mira, shumë vizatime të mira.

Bile na i mbyllën tani Institutin Albanologjik. Aty e mbajtëm ekspozitën, tani me qato punime i patëm marr, une, Ajnishahe Azemi edhe Hana Zylfiu. I mbështjellëm ato i pata qit në autobus nalt. Se u frigojshim po na i zonë, për ni fotografi ke mujt me shku në burg. E shkum në Tetovë edhe në Tetovë e kemi majt qat ekspozitën "Lufta në sytë e fëmive". Edhe me të vërtetë ka pas punime të bukra.

Anita Susuri: E kështu në këto marshet që jane organizu të grave, a keni marr pjesë, qysh ka qenë?

Hanëmshahe Ilazi: Kemi organizu shumë, çdo protestë na kemi marr pjesë. Mandej ka qenë ajo protesta ma e madhja me bukë në dorë drejt Drenicës. Une atë ditë nuk kom marr pjesë se unë veç kom qenë në Drenicë (buzëqeshë). Edhe kur erdha po i pys, "Çka u bo", thanë, "Te Fushë Kosova na kanë kthy. Po e dijmë që ti ke depërtu atje". Shumë kemi punu vallahi, shumë edhe shumë na kanë ndihmu, edhe mjekët sidomos, ato infermieret, motrat që kanë punu në spital.

Qekjo Xhemile Ruhani, Xheki, punojke ajo ambullanta që osht afër postës, ajo ka qenë përpara si ambullantë emergjente, e ndihmës shpejtë. Edhe une përnime gjithë kom pasë problem me komën, e mbështjellsha me fashë edhe mramje ajo më thirrke kur ishte kujdestare edhe shkojsha gjoja se për kontrollë. Ajo ma mushke mandej rretën me shprica, me injekcione, me barna, çka mujke. Kanë mledhë shumë mjekët qashtu na ndihmojshin edhe i çojshim në spital. Masanej aparaturë për

shembull ky Muharrem Gashi ka vdekë ai, kirurg trokal, ai aparatin na ka pasë dhonë me veti me çu në Drenicë, kundër gjakderdhjes. Shumë sene, po thom krejt populli ka qenë i aktivizum.

Aty afër Dodonës na patën leju ni si podrum u konë, përdhesë shumë e thellë, ni dhomë pa pare, aty u mledhshin ndihmat, populli prunte gjithçka. E prej aty mirrsha, mandej Berila, ni gru Naile Berila ajo na e pat leju atë dhomën. Bile Melihate Jaka profesoresha më pat tregu thojsha, “Pse sëm ke tregu ma herët e kisha shti në libër”. Thojke, “Sa herë je nisë ti për Drenicë...” se afër qasaj qendrës ku e kemi bo grumbullimin i ka pasë prindët ajo, i kanë banu aty, “e baba im e nëna ime” tha, “gjithmonë janë lut për ty, “ishalla kthehet gjallë” (qeshë). Çka me bo, qashtu kemi rreziku, po nuk jam pishmon edhe e ni vetin të lehtë që kom mujt dishka me kontribu.

Anita Susuri: E kur është vra familja Jashari a jeni shku?

Hanëmsaha Ilazi: Po, qysh jo. Në vorrim une s’kom mujt me mrri. Se çdo postbllok ka pas kontrolla, policë shumë. Djali motrës me dy shokë prej Ferizajit kanë shku me 11 mars, me 11 mars ka qenë vorrimi. Niherë ata varros e ç’varros i merrshin kufomat se dijshin. Edhe janë taku me profesorin Zekirja Canën, ai ka pasë fotoaparati me veti ka fotografu. Edhe kur jena afri te Prekazi... se kjo shumë më boni përshtypje ni ditë në bibliotekë, tash vonë, në zyre të sekretarit të bibliotekës, Bibliotekës Kombëtare, aty ni bashkëpuntore po thotë, “A ka qenë patriot Zekirja Rexha [Cana] se e kena pa pike raki në ballkon me kojshi sërbe” a s’di çka.

Thash, “O njerëz na jemi të prirur me i etiketu njerëzit”. E thash, “Qe po ta kallxoj ni rast” qe edhe ty Anitë po ta tregoj, ai bashkë me nipin tem, nipi jem ka qenë i burgosur politik, tetë vite ka qenë i denum, katra i ka majt, ja kanë bo gjysë. Edhe kur kanë mrri te Prekazi nuk kanë dasht me i lonë me hi, mu afri në vorrim, ata me automata {bën sikur mban armë në duar}. Ai tha, “Qysh ka qenë veç e ka hap sakon” {bën sikur shpërthakon dhe hap bluzën} edhe i ka thonë, “*Pucaj piçka ti materina* [Gjuaj, sharje] Gjuj, keni vra fëmijë e gra e pleqë e mu vranëm pune e madhe”. Tha, “Si e pat automatin kështu veç e lëshoj teposhtë” {përshekruan me duar}. Edhe na lëshoj, “Shkoni”.

Po du me thonë që krejt poplli ka qenë i aktivizum edhe me ndihmu. Se lufta nuk bohet vetëm me pushkë, lufta bohet edhe me pare edhe me pendë edhe me jetë. Se krejt poplli s’ka mujt em marr pjesë në luftë po në mënyrën e vet. Ato gratë e Drenicës e të gjitha zonave ku ka qenë lufta ju kanë gatu me muj, ju kanë la rrobat edhe ajo është pjesëmarrje në luftë. Edhe kisha pasë dëshirë që qato gra me qenë veterane. E jo u rritë numri palidhje që se kanë pa luftën me sy, kanë qenë në Angli e janë bo veteran.

Anita Susuri: E bombardimet kur kanë fillu, keni qenë në shpi këtu?

Hanëmsaha Ilazi: Tanë kohën, se e kom pasë në mbikëqyrje ni gru me nontë fëmi edhe dy të kunatit i ka pasë, ni çikë të migjës. Domethonë fëmijë edhe ajo dhetë, edhe dy, dymdhetë vetë i kom pasë në

shpi niherë po tani këtu na hini ushtria, une me burrin shkum në shpi të prindërve të nusës teme. Abdyl Rama ka qenë aktivist profesor, ai i pat vendos në Taslixhe qaty afër shtëpisë vet edhe më lajmëroj me telefon. Deri me 7 prill '99, telefonat kanë funksionu. Telefonat e shpisë se s'kena pasë mobila atëherë edhe gati për çdo ditë kom ardhë prej ngrohtores atje me burrin e në Taslixhe në komë shkojshim, rrugicave u sillshim.

A këtu tenka ka qenë në garazhë, a dy shpija ma poshtë në shtëpi të doktorit Sami Rexhepit aty e kanë pasë shtabin, ushtria ka qenë, ushtria e rregullt. Veç e kishin bo shpijën o Zot! Ibret, Ibret! E bibliotekën e kom pasë nalt në katin e tretë se përpara ndryshe e kena pasë planin, tani mas luftës fëmijtë e rregullun kate, kate edhe mirë u bo secili me pasë katin e vet. Librat veç mi kishin qit nëpër tokë, kanë kqyr mos ka pare nëpër libra. Përndryshe kështu s'kanë bo naj dom, po flliqtë e kishin pasë bo.

Anita Susuri: Edhe gjatë gjithë kohës keni qenë në Prishtinë nuk jeni largu?

Hanëmsaha Ilazi: Dy herë na kanë shti në kolonë, dy herë kena ikë prej kolonës. Kajher thojsha, "Po shumë e mëçme u bona, pse edhe na nuk shkumë ku shkun krejt". Po i kisha në mbikëqyrje qata fëmi najher ni kontë djathë, marmellatë, çka gjejsha ju prujshim. A në komë prej ngrohtores në Taslixhe nalt për çdo ditë gati që kemi shku te ata fëmijë me i vizitu.

Anita Susuri: E qysh ka qenë qajo ecje, qysh ka qenë qyteti, vendi?

Hanëmsaha Ilazi: Qyteti ka qenë i vdekun, rrallë kush që dilke, gjithka policë, tenka. Qekjo rruga ka keni ardhë prej xhamijës Pashës atje në kryq s'ka pasë qishtu ndërtesa gjithka, ku ka pasë zbrazëti u knoë ni tenk aty edhe u knoë i kamuflum. Ushtri gjithka ka pasë na i bishim biletë rrugicave anej mrapa ka "Gjergj Fishta" ka shkolla e u përbirojshum, po rrezik ka qenë. Po po thom kena punu me shpirt, jo për emër a për diçka, po na ka ruajt Zoti nuk na kanë vra.

Anita Susuri: A ju ka ndalë najher policia?

Hanëmsaha Ilazi: Na ka ndalë qysh jo. Burrin e kom pasë person të njoftun, ka qenë në detyra para luftës drejtor i Bankës së Kosovës, ka qenë ministër i financave, ma së fundi ka qenë drejtor i fabrikës gypave në Ferizaj, prej drejtorëve të parë e kanë largu prej punës edhe ku është shkolla "Elena Gjika" përfuni ajo ka qenë Gjyqi i Punës Bashkuar përpara, e qaty plotë ushtarë ka pas edhe te gjimnazi e kanë pasë shtabin, edhe kur kalojshim andej pari, ka shpija pleqve rrugicave po thom tani dilshim knej për me shku nalt në Taslixhe.

Njeri gjallë, a beson edhe zogjë po më doket nuk ka pasë, lule, bari u pat rritë kijamet. Edhe qata ushtarakët ni serb e njihte edhe sa herë kalojshum që kish mi thonë, "Si je, *zdravo Iljaze*" a dinë me ja bo me dije që osh shiptar ky. Po burri thojke, kur jonë shumë mos u tut veç kur jonë pak na vrasin. Çka me bo qishtu.

Anita Susuri: E kur hini NATO-ja, kur përfundoj krejt?

Hanëmshahe Ilazi: E kur hini NATO atëherë gëzimi jonë, dulëm krejt. E para se me hi NATO nja dy ditë - tri, se mandej e ndërrun nuk ishim në banesë atje te ngrohtorja po te Qafa, te Qafa në banesë të djalit agjës tem. Ai pat metë vet, gruja me djemë patën dal. Edhe ne në ballkon tu kqyr, çka me bo, kjo pjesa prej Dragodanit, ajo shumë më ka lonë përhstypje, shumë jom prekë, edhe i thash burrit, “Ec me pa”. Lopë, kuaj, vjeta nëpër qendër tu kalu.

A niherë tu u kthy na prej këtyne fëmive që i takum... shkret po thom s’ka pas njerëz rrugët thatë, thatë kanë qenë. Në fund qatje ku po pi kafe une përball bibliotekës, ish bibliotekës “Hivzi Sylejmani” osht nifarë kafe e vogël montazhë aty “Korner” thirrët, qaty kemi qenë, na tu kalu me burrin, një qysh me thonë, ni turmë e madhe qejsh, edhe qejë jo rrugaç po qejë të shpisë me zingjirë qysh i kanë lëshu. Ata kanë pasë me na çky, se as s’patëm gurë as kurgjo në dorë. Po qat’herë na shpëtoj vetura e policisë. Ata kalun, ata qejtë u largun edhe na kalum.

Qat’herë jam frigu se interesant të hupke friga, kurrë s’kom ditë me u frigu hiç. E burrin nuk e lejsha, une herët dilsha me gjetë bukë, se as bukë su gjejke, merrsha bukë ose najsën me ble, edhe u kthesha edhe po thom qysh s’kom ditë me u frigu a edhe në qytet kishin do, a dhunime a gjithçka.

Anita Susuri: Pastaj pas luftës keni fillu me mledhë të dhana, me publiku libra...

Hanëmshahe Ilazi: Po, mas luftës, ma së pari e kom publiku ni monografi për gjeneratën time të Normales, për dyzet vjetorin e maturës e kom bo ni libër, “Falemnderit Ferizaj” (buzëqeshë) e kom publiku, 2006-tën e kom botu. Mandej 2007-tën “Drenicë jemi me ty”. Mandej 2008 a 9, qato për familjen, rrojt e familjes Sopa dhe Hoxha. Mandej e kom shku ni monografi për ni dëshmor ai ka qenë organizatori kryesor i protestave ‘68-shit për Ferizaj, ma së pari janë majt në Ferizaj, ai në binë [skënë] i ka lexu kërkesat, tani ata krejt kanë ardhë në Prishtinë. E ato me 26 mars ‘99-tën e kanë masakru. E kur e ka bo dhetë vjetorin 2009, ja kom bo ni monografi “Ismet Ramadani - Një jetë për atdhe”. Ka qenë edhe nëpër burgje gjithka.

Mandej e kom bo ni monografi për Bije Vokshin 2012 për niqin vjetorin e shtetit amë edhe 2012 e kom bo edhe librin “A vriten engjujt?”. Ma vonë e kom bo librin “Gratë e njohura te trojeve shqiptare” mbas “Gratë e njohura te trojeve shqiptare”, mbas dy vite a tri e kom bo “Gratë e huaja për shqiptarë dhe Shqiptarët e diasporës”. Këto dyja mi ka botu koha, Flaka [Surroi] mi ka botu. Edhe mas atyne prapë ribotimi i “A vriten engjujt” edhe “Fëmijët martirë të Kosovës” anglisht, shqip me Nusret Pllanën. E tash jam ka e boj qet monografinë, inshallah jam shnosh e kry, qekjo diçka më ka lodhë po besoj që ka me qenë mirë (buzëqeshë).

Anita Susuri: Veç suksese edhe juve! Zonja Hanumshahe nëse keni edhe diçka me shtu për fund?

Hanëmshahe Ilazi: S’po di, kom shumë po, po më mbështillën tash. Pak mosha, kam fillu me harru (qeshë).

Anita Susuri: S’ka problem, çka do që doni. Nëse doni pushojna pak?

Hanëmshahe Ilazi: Anitë, osht mirë... kam vërejtje për Akademinë e Shkencave tonën. Ata duhet me pasë një program, një plan kombëtarë çka me bo, qysh me avansu, qysh me forcu shtetin, shtetësisjen, ata Akademia e Shkencave sërbe, gjithmonë në bazë të akademisë ata kanë vepru, këta tonët po flejnë. Une pata thonë kom qenë në emision te Oksigjeni, te Besimi [Dina], thash, “Nuk duhet me shkru Hanëmshahi, as Jusuf Osmani, as Nysreti, po duhet akademia me bo, se kur shkrun akademia e ka ekipën e vet edhe janë gjanat ma reale ma të sigurta”.

Se nuk bon mu harru historia, poplli që e harron historinë e vet ajo i përsëritet edhe neve shqiptarëve shpesh, shpesh na u ka përsërit historia. Na u ka përsërit 1876-78, 1912-’13-’14-’18-’41-’45 edhe tash në fund. Rrezik osht që me na u përsërit prapë, nuk duhet me harru. Osht aty ni thanje e presidentit Kenedi, “Armikun duhet ta falim...” jo, “Gjaku i derdhur kurrë mos të harrohet, armikun duhet ta falim po kurrë mos t’ia harrojmë emrin”. Po du me thonë që na harrojmë, shqiptarët harrojnë shpejt. Edhe po më brengosë shumë Anitë që e harrum luftën, e harrum luftën.

Na nuk jemi popull qe luftojmë për territore, për me u zgjanu, për me i pushtu tjerët, po kemi luftu me mbrojt vendin tonë. Nuk jem agresorë, mbrojtës. Mirëpo mbas qesaj lufte une, mendimi im është që bash qeta komnadantat, qeta, udhëheqësat e harrun gjakun e shokëve të vet, gjakun e gjithë atyne fëmive, viktimave, nuk di, nuk di. Nuk jam e kënaqun. Mas gjithë atyne sakrificave, me harru me mendu veç për veti nuk osht mirë.

Anita Susuri: Ju falemnderit shumë juve!

Hanëmshahe Ilazi: Nuk di çka me thonë ma shumë. Falemnderës edhe prej juve! Edhe po ju përgëzoj për këtë iniciativë, me të vërtetë mirë osht, ani gojore po kjo edhe mbetet masi po inçizohet, po shkruhet. Se na qishti i kemi rujt, gojë mas goje tu përcjellë gjeneratave, se pak kemi pasë njerëz të lapsit.

Anita Susuri: Falemnderit edhe njëherë ishte knaqësi!